REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 266/20
Datë/Datum. 12.06.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH .nr.266/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z.Blerim Dina - Referues dhe z.Goran Milenković – Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE "Telekomi i Kosovës "sha - Prishtinë, kundër njoftimit mbi dhënien e kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:"Furnizim dhe shërbime të internetit VPN dhe WLAN për Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", me nr. prokurimi: 242-20-1190-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) — Universiteti "Hasan Prishtina", më datën 11.06.2020, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit OE "Telekomi i Kosovës" sha - Prishtinë,kundër njoftimit mbi dhënie te kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit :"Furnizim dhe shërbime të internetit VPN dhe WLAN për Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", me nr. prokurimi: 242-20-1190-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) — Universiteti "Hasan Prishtina".

II.ANULOHET, njoftimi për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim dhe shërbime të internetit VPN dhe WLAN për Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", me nr. prokurimi: 242-20-1190-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) — Universiteti "Hasan Prishtina".

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues aprovohet si pjesërisht e bazuar, të njëjtit operator ekonomik i kthehet tarfia e paguar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues "Telekomi i Kosovës" -Prishtinë, që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues OE "Telekomi i Kosovës" sha - Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 24.04.2020 me nr. 266/20, kundër njoftimit mbi dhënien e kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim dhe shërbime të internetit VPN dhe WLAN për Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", me nr. prokurimi: 242-20-1190-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) — Universiteti "Hasan Prishtina" duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 9.4 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 04.05.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 12.05.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

<u>Sqarim Hyrës:</u> Autoriteti Kontraktues - "Universitetit "Hasan Prishtina", gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedure të hapur, Iloji i kontratës është shërbim me vlerë të mesme. Pretendimet kryesore ankimore kanë ti bëjnë kundër njoftimit për kontratë.

<u>Përgiigje në pretendimin ankimore 1 (neni 113):</u> Pretendimet ankimore edhe tani kanë të bëjnë kundër procedurës së aplikuar nga autoriteti kontraktues, rrjedhimisht kërkohet anulimi i kësaj procedure me qëllim që AK—Universiteti "Hasan Prishtina", për këto shërbime të përjashtohet nga legjislacioni për

prokurim publik, në kuptimin që të aplikohet procedura e negociuar pa publikim të njoftimit me arsyetimin se një gjë të tillë e parasheh neni 9, paragrafi 4, i LPP-se, si dhe një interpretim i dhënë nga KRPP.

Në përrmes Raportit të datës 27.01.2020, me numër 48/20, e kemi trajtuar këtë aktivitet të prokurimit dhe kemi dhënë rekomandimet tona, përkatësisht kemi sqaruar se, neni 9, si tërësi, përfshirë edhe paragrafin 4, parasheh planifikimin paraprak të prokurimit sipas nevojave që ka një Autoritet Kontraktues i caktuar, por assesi përjashtimin nga procedura e prokurimit publik apo të drejtën për aplikim të procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit. Për të njëjtën procedurë në dispozitat e nenit 35, të LPP-së, sqarohet kur një Autoritet Kontraktues mund të përdor procedurat e negociuara pa publikim paraprak të njoftimit.

Parashtruesi i ankesës "Telekomi i Kosovës" sha, është thirrur edhe në praktikat paraprake të vendimmarrjes në OSHP, përkatësisht i është referuar vendimeve me nr. 338/19, të datës 16.08.2019 dhe nr. 409/19, të datës 04.09.2019, se fundmi edhe në vendimin e datës. 11.03.2020, me nr.48/20, i nxjerre pikërisht për këtë aktivitet të prokurimit, ku është anuluar njoftimi për kontratë dhe është obliguar AK — Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", përveq tjerash, që Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", ti referohet interpretimit të KRPP-së.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, përkatësisht meqë paneli shqyrtues tani më ka nxjerr vendim per ketë aktivitet te prokurimit, AK, të anuloj njoftimin për kontratë siç është urdhëruar përmes vendimit me nr 48/20, te datës 11.03.2020.

Autoriteti Kontraktues, nuk e ka njoftuar OSHP-në, se a pajtohet apo jo me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, nuk e ka njoftuar OSHP-në, se a pajtohet apo jo me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 00.05.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues/teknik të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues/teknik deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për kontratë.

Pretendimet ankimore edhe tani kanë të bëjnë kundër procedurës së aplikuar nga autoriteti kontraktues, rrjedhimisht kërkohet anulimi i kësaj procedure me qëllim që AK—Universiteti "Hasan Prishtina", për këto shërbime të përjashtohet nga legjislacioni për prokurim publik, në kuptimin që të aplikohet procedura e negociuar pa publikim të njoftimit me arsyetimin se një gjë të tillë e parasheh neni 9, paragrafi 4, i LPP-se, si dhe një interpretim i dhënë nga KRPP.

Paneli shqyrtues sqaron se për këtë aktivitet të prokurimit ka shqyrtuar ankesën me numër 48/20, dhe ka konstatuar se AK ka qenë dashur që të marrë në konsideratë nenin 9. 4 të LPP-së si dhe interpetetimin e KRPP-së nr. 36, ku thuhet: "...Ligji për Prokurim Publik gjegjësisht neni 9 paragrafi 4, kërkon nga Autoritetet Kontraktuese që të veprojnë si në vijim: "*Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik, autoriteti i tillë publik duhet të marrë masa të arsyeshme për t'u siguruar se lëndët që i përmbushin këto nevoja nuk janë në dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik". Pra neni i lartëcituar rregullon rastet kur Autoriteti Kontraktues (Autoriteti Publik) ka nevojë për sigurimin e shërbimeve operator i të cilave po ashtu është një autoritet publik. LPP, nuk e sqaron me tej se si autoritet publik do te rregullojnë plotësimin e nevojave te tyre (ne mes vete) meqë kjo është çështje e autioriteteve publike dhe/ose rregullave tjera. Mirëpo është mëse e qartë se këto raste kanë të bëjnë me <u>përjashtimet nga zbatimi i legjislacionit që rregullon prokurimin publik</u> kur një formë e partneritetit publiko privat realizohet (një AK mund të kërkojë ofrimin e një shërbimi në shërbimet e tijë ose shërbimeve te një autoriteti tjetër kontraktues pa inicuar ndonjë procedurë tenderimi, të ashtuquajtura përjashtim " në shtëpi). Si përfundim pas analizimit të cekur më lartë (neni 9.4 të LPP-së) dhe të kërkesave tuaja, meqë nuk ka asnjë dispozitë tjetër për të LPP-ës e cila i obligon Autoritetet Publike që të marrin masa për të mos lejuar "shtrembërimin e konkurrencës" (sikur ato nga direktiva e BE-es, neni 12.1) KRPP nuk ka se si të mos e trajtojë këtë çështje ashtu sikur është vendosur në nenin 9.4 te LPP-së*", ky pretendim ankimor i OE ankues është i bazuar.

AK- Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" nuk ka respektuar dispozitat e nenit 9. 4 të LPP-së me rastin e dhënies së kontratës pa marrë masat dhe pa verifikuar se lëndët që i përmbushin këto nevoja nuk janë në dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik, në rastin konkret nga Telekomi i Kosovës sh. a.

Paneli Shqyrtues sqaron se neni 9. 4 i LPP-së përben një detyrim për të ekzaminuar disponueshmërinë me autoritetet e tjera kontraktuese për shërbimet që do të marrë një autoritet publik, e që në rastin konkret AK- KK Prizren nuk e ka përmbushur një detyrim të tillë.

Paneli shqyrtues me rastin e marrjes së këtij vendimi poashtu ka marrë parasysh vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 05/21 të datës 02 prill 2020, ku sipas këtij vendimi aprovohet propozimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, për përjashtim nga fushëveprimi i Ligjit për Prokurim Publik për shërbimet telekomunikuese që ofron "Telekomi i Kosvës sh. a", si shërbime me rëndësi të vecantë shtetërore në harmoni me nenin 3. 1 dhe 9. 4 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi Paçarizi

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina",

1x1 *OE ankues* - "Telekomi i Kosovës" sha,

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.